

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7931
E premte, 15 nëntor 2024
Çmimi 0.50 €

Si e sheh botën Marco Rubio, i zgjedhuri i Trumpit për sekretar të Shtetit? | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KU MBETËN LINJAT HEKURUDHORE DHE AJRORE, TË PARAPARA ME MARRËVESHJEN E UASHINGTONIT? | FAQE 4-5



Shumë pika të Marrëveshjes së Uashingtonit, në nënshkrimin e së cilës mori pjesë presidenti i zgjedhur amerikan Donald Trump, mbeten pa u zbatuar. Presidenti i zgjedhur i

Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, do ta fillojë mandatin e ri në janar të vitit 2025. Në shtator të vitit të ardhshëm do të bëhen pesë vjet prej se Trumpi, i cili ka shërbyer

president edhe nga viti 2017 deri më 2021, ka marrë pjesë në nënshkrimin e Marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike në mes të Kosovës dhe Serbisë

CLARKU NË PRISHTINË, E ARDHMJA E KOSOVËS NË PARTNERITET TË QËNDRUESHËM ME SHBA-në | F. 5



GUEROT: FRANCA PRET NGA KOSOVA TA DËRGOJË DRAFTIN EVROPIAN NË GJYKATËN KUSHTETUESE | F. 3



OPINION

DALLIMET MIDIS DEMOKRATËVE DHE REPUBLIKANËVE NË SHBA PËR KOSOVËN DHE INTEGRIMIN E SAJ NË ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE | F. 6

Nga Washington DC, shkruan: Prof. dr. Fejzulla BERISHA



AKTUALE



RRETH 10 PËR QIND E POPULLATËS NË KOSOVË E PREKUR NGA DIABETI | F. 7

KOMISIONI I POSAÇËM PROCEDON PËR SEANCË PESË KANDIDATË PËR EMËRIM NË KUSHTETUESE | F. 7

EKONOMI

GUVERNATORI ISMAILI NË TIRANË FLET PËR REFORMAT E NDËRMARRA NGA BQK-ja | F. 8

PËRFAQËSUES TË ATK-SË MARRIN PJESË NË TAKIMIN RAJONAL PËR MENAXHIMIN E RISKUT TË PËRMBUSHJES (MRP) | F. 8

SPORT



KOSOVA SYNON FITORE NË 'FINALEN' NDAJ RUMANISË | F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Si e sheh botën Marco Rubio, i zgjedhuri i Trumpit për sekretar të Shtetit?

WASHINGTON, 14 NËNTOR - Presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, zgjodhi më 13 nëntor senatorin Marco Rubio kryediplomat të tij, në kohën kur administrata e ardhshme po përgatitet të navigojë nëpër një botë gjithnjë e më të rrezikshme - me luftëra në Evropë dhe Lindje të Mesme, si dhe me një konkurrencë në rritje të Kinës në Azi-Paqësor.

Me zgjedhjen e Rubios - senator i njohur për qëndrime të ashpra në shumë çështje të politikës së jashtme - Trumpi kërkoi dikë që ndan kryesisht pikëpamjet e tij për temat më urgjente ndërkombëtare, thotë Behnam Ben Taleblu, analist në Fondacionin për Mbrojtjen e Demokracive, me bazë në Uashington. "Rubio është dikush që ka përafrim ideologjik dhe politik me Trumpin për disa çështje të rëndësishme të sigurisë kombëtare, si konkurrenca e fuqive të mëdha, kundërvënja ndaj Iranit dhe rivendosja e fushatës së presionit maksimal", thotë Taleblu për Radion Evropa e Lirë.

Në një intervistë dhënë javën e kaluar, përpara se të emërohej në pozitën e sekretarit të Shtetit, Rubio tha se periudha prej dekadash e dominimit të pakundërshtueshëm global të ShBA-së, pas rënies së Bashkimit Sovjetik, ka përfunduar dhe është zëvendësuar me një epokë të re të ngjashme me Luftën e Ftohtë.

Ai tha se Shtetet e Bashkuara nuk mund të dobësohen shumë përmes angazhimeve globale dhe shtoi se Uashingtoni duhet të jetë "pragmatik" në politikën e jashtme. "Ne jemi [vend] më i fuqishëm, por edhe ne kemi burime të kufizuara... Kështu që duhet ta investojmë kohën dhe paratë tona në gjëra që i shërbejnë interesit tonë thelbësor kombëtar", tha Rubio në një intervistë për rrjetin kabllor në ShBA, EWTN, më 7 nëntor.

Rubio, kubano-amerikan, luajti rol me ndikim në formësimin e politikës së Trumpit ndaj Venezuelës, gjatë mandatit të parë të tij si president nga viti 2017 deri më 2021.

"New York Times" e përshkroi Rubion në atë kohë si "sekretar virtual të Shtetit për Amerikën Latine".

Senatori nga Florida, i cili e sfidoi Trumpin në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016, merr detyrën me përvojë të madhe në politikën e jashtme, pasi shërbeu edhe në Komitetin e Inteligjencës në Senat, edhe në Komitetin për Marrëdhënie me



Jashtë.

Nëse konfirmohet përfundimisht nga Senati, Rubio, 53 vjeç, bëhet latini i parë që shërben si sekretar i Shtetit.

Dhe derisa Amerika Latine do të jetë në fokus për Rubion, shqetësimet më të ngutshme të politikës së jashtme të ShBA-së - si ngritja globale e Kinës, kërcënimi i Iranit për Lindjen e Mesme dhe pushtimi rus i Ukrainës - pritet të kenë rëndësi.

Prioriteti nr. 1: Kina

Kur bëhet fjalë për kërkesat për burime ushtarake, politike dhe financiare të ShBA-së, Rubio dëshiron që fokusi të jetë në Kinë. "Unë mendoj se e ardhmja e shekullit 21 do të përcaktohet kryesisht nga ajo që ndodh në Indo-Paqësor. Unë mendoj se Kina do të donte që ne të zhyteshim në një konflikt në Evropë dhe të mos fokusohemi në atë që po ndodh në Indo-Paqësor", tha Rubio më 7 nëntor.

Rubio, i cili shërbeu si bashkëkryetar i një komiteti dypartiak të Kongresit për Kinën, kërkoi vazhdimisht qasje më të ashpra ndaj Pekinit. Ai udhëhoqi përpjekjet për ta armatosur Tajvanin - një demokraci vetëqeverisëse, mbi të cilën Pekini pretendon se ka pronësi. Ai kërkoi dërgesa të drejtpërdrejta të municioneve amerikane dhe të teknologjive të avancuara ushtarake, me shpresën për ta penguar sulmin e mundshëm të Kinës në këtë ishull.

Rubio ishte, gjithashtu, i zëshëm për shkeljet e të drejtave të njeriut në Kinë, shtyu përpara një politikë industriale të ShBA-së për t'i

bërë konkurrencë më të mirë Kinës dhe mbështeti tarifën për mallrat kineze. Ai u përpoq t'i ndalonte importet e mallrave kineze, të prodhuara nga puna me detyrim e ujqurëve dhe pakicave të tjera myslimane në Kinën perëndimore dhe ta parandalonte Kinën që t'i anashkalonte tarifën e kohës së Trumpit, duke e zhvendosur prodhimin në Meksikë.

NATO-ja dhe Ukraina

Rubio mbështeti vazhdimisht sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës në luftën e saj mbrojtëse kundër Rusisë, ndërsa ukrainasit i përshkroi si "tepër të guximshëm dhe të fortë".

Në shkurt të vitit 2022, menjëherë pasi Rusia nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës, ai bashkësponsorizoi Aktin NYET në Senat, i cili synonte "t'i forconte aftësitë mbrojtëse të Ukrainës" dhe të vendoste sanksione ndaj Rusisë.

Por, Rubio tha, po ashtu, se lufta e Rusisë kundër Ukrainës ka hasur në "ngërç" dhe "duhet arritur në një përfundim". Ai ishte në mesin e një pakice senatorësh që, në fillim të këtij viti, e kundërshtuan një projektligj për ndihmën e huaj, e cila përfshinte 60 miliardë dollarë për Ukrainën. Projektligji u miratua përfundimisht në prill, duke e çuar vlerën e ndihmës totale të ShBA-së për Ukrainën që nga shkurti i vitit 2022 në pothuajse 175 miliardë dollarë - afërsisht sa krejt ndihma që ndau e gjithë Evropa së bashku. Rubio e nxori në pah këtë çekuilibër, duke thënë se Uashingtoni duhet ta shtyjë Evropën që të marrë një rol më

të madh në trajtimin e çështjeve të saj të sigurisë, në mënyrë që t'u mundësojë Shteteve të Bashkuara ta kenë prioritetin sfidimin e Kinës në Indo-Paqësor.

Në intervistën e javës së kaluar për EWTN-në, Rubio tha se është "joreale" të pritet që Shtetet e Bashkuara të miratojnë dhjetëra miliarda dollarë për Ukrainën çdo dhjetë muaj. Ai tha se anëtarët evropianë të NATO-s duhet ta rrisin kontributin e tyre në aleancë. "Çdo ditë në vendin tonë, [ne jemi] duke u përballur me pyetje se si t'u ofrojmë ndihmë amerikanëve", tha ai. Edhe pse Rubio e sheh Rusinë si kërcënim për sigurinë e ShBA-së dhe e mbështet sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, ai tha se Kievit do t'i duhet të negociojë për t'i dhënë fund luftës. Rubio tha se Rusia ka shumë burime në dispozicion, përfshirë armë dhe njerëz, për t'i vazhduar luftimet, edhe pse ka pësuar humbje të jashtëzakonshme.

Jo politikë qetësuese në Iran

Në Lindjen e Mesme, Rubio ka prej kohësh qëndrim të ashpra ndaj Iranit, duke e përshkruar qeverinë e tij teokratike si një "regjim terrorist" për shkak të financimit të grupeve të tilla si Hamasi dhe Hezbollahu - të dyja të cilësuar si organizata terroriste nga ShBA-ja. Si senator, ai ishte kritik i ashpër i marrëveshjes bërthamore të Iranit të vitit 2015, e arritur nën presidentin e atëhershëm amerikan, Barack Obama. E njohur si JCPOA, marrëveshja kufizoi programin bërthamor të Teheranit, në

këmbim të lehtësimit të sanksioneve kundër tij.

Kritikët e marrëveshjes thanë se ajo e fuqizoi Iranin, duke ia lehtësuar në masë të madhe sanksionet, pa ndonjë garanci se një ditë nuk do të prodhojë bombë bërthamore.

Në vitin 2018 Trumpi, i cili atëherë ishte president, e tërhoqi ShBA-në nga marrëveshja dhe rivendosi sanksionet ndaj Iranit.

Së voni, Rubio ishte bashkautor i tri projektligjeve që i dënojnë veprimet e Iranit, të cilat u shndërruan në ligje. Ato autorizojnë sanksionimin e eksporteve iraniane të naftës, të liderëve të lartë iranianë për shkelje të të drejtave të njeriut, si dhe të entiteteve të huaja dhe qeverive që mbështesin Hamasin.

Hamasi e sulmoi Izraelin në tetor të vitit 2023, duke shkaktuar një luftë rajonale, e cila kërcënon të përfshijë më shumë shtete.

Në shtator, Rubio e kritikoi administratën e presidentit aktual, Joe Biden, për zvarritje në zbatimin e sanksioneve kundër naftës iraniane. Ajo nuk arriti t'i shtynte përpara as sanksionet në fushën e të drejtave të njeriut.

Varësisht asaj me çka do të përballet administrata e ardhshme në Iran kur ta marrë detyrën, analisti Taleblu pret që Departamenti i Shtetit, i udhëhequr nga Rubio, ta monitorojë zbatimin e sanksioneve.

Si përkrahës i zëshëm i Izraelit, Rubio thotë se e mbështet të drejtën e tij për t'u mbrojtur nga kërcënimet iraniane.

Pas sulmeve raketore të Teheranit në Izrael më 1 tetor, Rubio mbështeti publikisht përgjigje asimetrike.

Afganistani

Rubio ka, gjithashtu, qëndrim të ashpër ndaj talibanëve, duke argumentuar se grupi militant islamik duhet të përshkruhet si "organizatë terroriste" nga Uashingtoni.

Në mars, senatori i Floridës paraqiti një projektligj në Senat, i cili bën thirrje për t'i dhënë fund ndihmës së ShBA-së për Afganistanin e sunduar nga talibanët, duke thënë se disa nga ato para mund të përfundojnë te "grupet terroriste".

Në komentet për Senatin, Rubio tha: "Një Afganistan i kontrolluar nga talibanët përbën një kërcënim të drejtpërdrejtë për interesat e sigurisë kombëtare të ShBA-së dhe për aleatët tanë në Lindjen e Mesme dhe në Azinë Qendrore". / REL

Haradinaj jep propozim për PDK-në dhe LDK-në, kërkon të ndahet pozita e kryeministrit me nga një vjet

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, në një intervistë për rtv21, ka propozuar që pas zgjedhjeve të përgjithshme, të bëjnë bashkëpunim me PDK-në dhe LDK-në për pozitën e kryeministrit. Sipas tij, Albin Kurti nuk është opsion për këtë bashkëpunim. Siç tha ai, Kurti nuk do të jetë më kryeministër. "Kurti nuk është më kryeministër. Ju kam thënë edhe më herët kështu. Nuk do të jetë më kryeministër Albin Kurti. Nuk qeveris Vetëvendosja më. Me qenë në vend të tij e kisha shkruar qysh tash një fjalim të opozitarit të ardhshëm. Kisha dërguar sinjale që nuk do ta mbaj vendin peng më. Ju po e shihni se si po ndodhin ndryshimet e shpejta në

Gjermani. Brenda 24 orëve ka tronditje në qeverinë gjermane. Nuk është mirë Kurti ta vonojë veten. Ka pasoja dhe thellon pasojat. Ne nuk kemi qare pa i sanuar këto pasoja. Për këtë arsye unë e kërkoj udhëheqjen e qeverisë, qoftë me rotacion që tre opozitarët të merren vesh njëri një vit, tjetri një vit, tjetri një vit. Unë kërkoj udhëheqjen e qeverisë në fillimin e qeverisjes me qëllim që t'i kthejmë këto marrëdhënie të besueshme, kontraktuale me ShBA-në dhe aleatët e tjerë. Me i krye disa punë të vështira që pastaj qeverisja me qenë e zakonshme, e zhvillimit ekonomik. Por, vazhdimi i mbetjes në pushtet i Kurtit nuk është opsion. Është e kryer kjo pjesë", ka thënë Haradinaj.



Guerot: Franca pret nga Kosova ta dërgojë draftin evropian në Gjykatën Kushtetuese



PRISHTINË, 14 NËNTOR - Ambasadori i Francës në Prishtinë, Olivier Guerot, në një intervistë për portalin "Kosovo-Online" të enjten, ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet ta zbatojnë sa më shpejt marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve të arritur vitin e kaluar, fillimisht në Bruksel të Belgjikës, pastaj në Ohër të Maqedonisë së Veriut. "Në një kontekst shumë të pasigurt ndërkombëtar, i cili karakterizohet nga vazhdimi i agresionit të Rusisë kundër Ukrainës dhe stabiliteti thellësisht i kërcënuar në Lindjen e Mesme, normalizimi i marrëdhënieve

ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mbetet sfidë e planit të parë dhe çështje e sigurisë evropiane", ka deklaruar fillimisht Guerot, duke shtuar se Marrëveshja e Brukselit dhe Aneksi i Ohrit duhet të zbatohen sa më shpejt nga të dyja palët. "Këto marrëveshje janë ligjërisht të detyrueshme dhe zbatimi i tyre është përfshirë në kapitullin 35 të negociatave të anëtarësimit me Serbinë, si dhe në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Kosovën", ka potencuar diplomati francez.

Guerot ka shtuar se Franca pret nga Qeveria e Kosovës ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese draft-

statutin për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, i cili është hartuar nga Bashkimi Evropian. Sa iu përket obligimeve Serbisë, diplomati francez ka nënvizuar se autorët e sulmit në Banjskë të Zveçanit duhet të nxirren para drejtësisë.

Kosova dhe Serbia kanë arritur një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve në shkurt/mars të vitit 2023. Megjithatë, përkundër insistimit të diplomatëve amerikanë dhe evropianë se Marrëveshja e Brukselit dhe Aneksi i Ohrit janë ligjërisht obliguese, ende nuk ka filluar implementimi i asaj që në publik njihet si nisma franko-gjermane.

Osmani me komandantin e KFOR-it diskutuan për sigurinë në vend

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Presidentja Vjosa Osmani ka takuar komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Enrico Barduanin, me të cilin kanë diskutuar për çështje të sigurisë në vend. Në këtë takim presidentja Osmani ka nënvizuar përkushtimin e vazhdueshëm për një Kosovë të sigurt dhe stabile, si parakusht për zhvillim e prosperitet, ndërsa ka rikonfirmuar rëndësinë e koordinimit ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe partnerëve ndërkombëtarë, për çështje të sigurisë, me qëllim të mbrojtjes së të gjithë qytetarëve tanë dhe mbrojtjes së sovranitetit të vendit.

Në këtë linjë Osmani vazhdon të ketë takime të rregullta me komandantin e KFOR-it, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit me partnerë të

sigurisë, veçanërisht me NATO-n. Presidentja Osmani shprehu mirënjohje për KFOR-in, i cili ka shtuar numrin e trupave e të cilët po mbështesin institucionet e Kosovës në patrullim të kufirit me Serbinë. Presidentja ripotencoi rreziqet që vijnë nga taktikat destabilizuese të Serbisë, sidomos për shkak të mungesës së dhënies së përgjegjësive nga ana e Serbisë, si për aktin e agresionit të shtatorit 2023, po ashtu edhe për sulmet ndaj KFOR-it në maj 2023. Ndër të tjera, në këtë takim presidentja Osmani dhe komandanti Barduanin pohuan angazhimin e tyre të përbashkët për ruajtjen e një mjedisi të sigurt për të gjithë qytetarët, duke pranuar se bashkëpunimi dhe besimi i ndërsjellë janë bazë për paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm.





Ku mbetën linjat hekurudhore dhe ajrore, të parapara me Marrëveshjen e Uashingtonit?

Shumë pika të Marrëveshjes së Uashingtonit, në nënshkrimin e së cilës mori pjesë presidenti i zgjedhur amerikan Donald Trump, mbeten pa u zbatuar. Presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, do ta fillojë mandatin e ri në janar të vitit 2025. Në shtator të vitit të ardhshëm do të bëhen pesë vjet prej se Trumpi, i cili ka shërbyer president edhe nga viti 2017 deri më 2021, ka marrë pjesë në nënshkrimin e Marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike në mes të Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, do ta fillojë mandatin e ri në janar të vitit 2025. Në shtator të vitit të ardhshëm do të bëhen pesë vjet prej se Trumpi, i cili ka shërbyer president edhe nga viti 2017 deri më 2021, ka marrë pjesë në nënshkrimin e Marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike në mes të Kosovës dhe Serbisë. E njohur si Marrëveshja e Uashingtonit, ajo është arritur më 4 shtator të vitit 2020 dhe përmban disa pika - nga krijimi i linjave ajrore dhe hekurudhore në mes të Kosovës dhe Serbisë deri te njohja e Kosovës nga Izraeli. Derisa kjo e fundit është përmbushur, shumë pika të tjera mbeten pa u zbatuar. Ish-zyrtarë të institucioneve të Kosovës që kanë kontribuar në arritjen kësaj marrëveshjeje, por edhe njohës të ekonomisë, thonë se ajo është e leverdishme dhe duhet zbatuar. Në mesin e pikave më të rëndësishme për qytetarët e të dyja vendeve, ata i vlerësojnë ato që lidhen me lëvizjen e lirë - përkatësisht hekurudhën dhe

linjën ajrore - por që nuk janë zbatuar. Me Marrëveshjen e Uashingtonit është paraparë ndërtimi i hekurudhës Prishtinë - Merdar dhe Nish - Prishtinë. Ajo ka paraparë edhe krijimin e një linje ajrore midis Prishtinës dhe Beogradit dhe anasjelltas, në të cilën do të operonte kompania gjermane ajrore "Lufthansa". Radio Evropa e Lirë pyeti Qeverinë e Kosovës se përse nuk është punuar në zbatimin e këtyre pikave dhe a pritet, por nuk mori përgjigje. Marrëveshja, në fakt, është nënshkruar nga ish-kryeministri Avdullah Hoti, vetëm disa muaj para se kryeministri aktual, Albin Kurti, ta merrte pushtetin. As Hoti nuk iu përgjigj interesimit të Radios Evropa e Lirë për këtë temë. Ramë Çupeva, i cili ka marrë pjesë në nënshkrimin e marrëveshjes për hekurudhën në cilësinë e drejtorit të atëhershëm të Departamentit të Infrastrukturës Rrugore, thotë se marrëveshja "është ndër më të mirat" që ka bërë Kosova me Serbinë. Ai thotë se e përkrah "pa rezerva" atë. "Zbatimi i saj i ka

takuar qeverisë. Por, pas ndërrimit të qeverive, askush nuk ka bërë përpjekje për ta çuar përpara", thotë Çupeva për Radion Evropa e Lirë. REL-i kontaktoi zyrtarët e tanishëm në Departamentin e Infrastrukturës Rrugore, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës, por ata nuk u përgjigjën. Nga "Infrakos"-i - kompania që operon rrjetin hekurudhor të Kosovës - konfirmuan se nuk kanë nisur ndonjë punë në hekurudhën Prishtinë - Merdar. "Ne, si 'Infrakos' jemi të gatshëm që kurdo që të arrihet praktikisht marrëveshja për zbatimin [e projektit], t'i marrim veprimet tona", thuhet në përgjigjen dërguar REL-it. Situatë e ngjashme është edhe me linjën e paraparë ajrore në mes të Prishtinës dhe Beogradit dhe anasjelltas. Më shumë se katër vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Uashingtonit, midis dy vendeve nuk fluturon ndonjë avion. Kompania "Lufthansa", e paraparë të operonte në këtë linjë, nuk iu përgjigj pyetjes së Radios Evropa e Lirë se ku nga ngecur procesi. Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës thotë në një përgjigje të shkurtër për REL-in se "deri më tani nuk ka pranuar asnjë kërkesë nga kompania ajrore në fjalë për t'i filluar fluturimet në linjën Prishtinë - Beograd". Ndër nënshkruesit e marrëveshjes për linjën ajrore ka qenë edhe drejtori i atëhershëm i Aviacionit Civil, Eset Berisha. Ai kujton se atëkohë bota është përballur me pandeminë Covid-19 dhe

linjat ajrore kanë qenë të kufizuara. Por, edhe ai një pjesë më të madhe të fajit e hedh te qeveria e Kurtit, që ka marrë pushtetin pas asaj të Hotit. "Qeveria asnjëherë nuk ka treguar vullnet për ta shtyrë përpara këtë marrëveshje, kështu që ka ngecur", thotë Berisha për Radion Evropa e Lirë. Për njohësit e çështjeve ekonomike, jetësimi i këtyre projekteve do të duhej të bëhej sa më parë sepse, përveçse do ta lehtësonin lëvizjen e njerëzve, do të ndikonin pozitivisht edhe në qarkullimin e mallrave. Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, thotë se shpreson se me rikthimin e Trumpit në Shtëpinë e Bardhë do të kthehet edhe fokusi te zbatimi i Marrëveshjes së Uashingtonit sepse ajo, sipas tij, ndikon në zhvillimin ekonomik dhe në mirëqenien e qytetarëve. "Nuk është marrëveshje dosido, nuk është marrëveshje që është nënshkruar në ndonjë sallë apo hapësirë të panjohur. Është marrëveshje që është nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë, në Zyrën e Presidentit të ShBA-së dhe ka vlerë shumë të madhe", thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Kurti, pas fitores së Trumpit, është pyetur nga gazetarët nëse është e pranueshme për të Marrëveshja e Uashingtonit, por ai ka thënë se, fillimisht, pret që të nënshkruhet Marrëveshja e Brukselit. Për këtë të fundit, Kosova dhe Serbia janë pajtuar verbalisht vitin e kaluar në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Marrëveshja parasheh rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve, por në praktikë nuk është zbatuar. Aktualisht Kosova dhe Serbia lidhen përmes gjashtë pikave kufitare tokësore: Jarinjë, Bërnjak, Merdar, Mutivodë, Muçibabë dhe Dheu i Bardhë. Radio Evropa e Lirë kërkoi koment edhe nga Qeveria e Serbisë për Marrëveshjen e Uashingtonit, por nuk mori përgjigje.

Trump për Marrëveshjen e Uashingtonit

Në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes, presidenti i atëhershëm amerikan, Donald Trump, ka thënë se kjo është "një ditë shumë e rëndësishme dhe historike". Pas historisë së dhunës dhe negociatave të dështuara, ka thënë Trumpi, administrata e tij ka bërë një "përparim të madh" në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe "askush nuk ka menduar se kjo do të jetë e mundur". "Është dashur një trimëri e jashtëzakonshme nga presidenti i Serbisë, Vuçiq, dhe kryeministri i Kosovës, Hoti, për t'i filluar këto bisedime dhe për të ardhur në Uashington për t'i përfunduar këto zotime. Duke vepruar kështu, ata i kanë bërë vendet e tyre, Ballkanin dhe botën, më të sigurt", ka thënë Trumpi.

Delegacioni i ushtrisë gjermane viziton Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK një delegacion i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar i ushtrisë gjermane ka zhvilluar vizitë pune, ku janë realizuar bisedimet bilaterale në të cilat është

përpiluar plani bilateral M2M (ushtri me ushtri). Bazuar në këtë plan, përcaktohet mbajtja e aktiviteteve të përbashkëta ushtarake për vitin 2025 në mes të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Bundeswehr. Kjo ngjarje tradicionale në

mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë forcon lidhjen e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes si dhe ndihmon në rritjen e aftësive dhe kapaciteteve ushtarake të FSK-së.



Clark në Prishtinë, e ardhmja e Kosovës në partneritet të qëndrueshëm me ShBA-në

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 14 nëntor - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim gjeneralin Wesley K. Clark, ish-komandant suprem i NATO-s për Evropë, i cili udhëhoqi ndërhyrjen e NATO-s në vitin 1999, e cila luajti rol të rëndësishëm për lirinë e Kosovës. "Vendosmëria dhe lidhshipia juaj i kontribuuan lirisë së Kosovës, duke siguruar një të ardhme ku dinjiteti mbizotëron mbi frikën dhe shtypjen", ka theksuar presidentja Osmani.

Në takim me gjeneralin Clark, presidentja Osmani theksoi përparimin e Kosovës ndër vite, duke vënë në dukje punën e vazhdueshme për ta forcuar pozitën e Kosovës në skenën ndërkombëtare, sikurse edhe anëtarësimin në

organizata ndërkombëtare. Sipas Osmanit, e ardhmja e Kosovës është e qartë në synimin për integrimin euroatlantik dhe partneritet të qëndrueshëm me Shtetet e Bashkuara.

Edhe ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur në takim gjeneralin amerikan Wesley Clark, të cilit i shprehu mirënjohjen e popullit të Kosovës për udhëheqjen e fushatës ajrore të NATO-s kundër forcave ushtarake të regjimit pushtues serb.

Ministri e informoi gjeneralin Clark mbi përparimin e ndjeshëm të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për realizimin e objektivave të dakorduara në kuadër të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit.

Ai ka theksuar se niveli i lartë i profesionalizmit që Forca e Sigurisë së Kosovës dëshmon



sot, para së gjithash, është rezultat i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit të ngushtë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë ndërmjet vendeve tona, për çka kontributi i gjeneralit Clark ka qenë dhe mbetet tejet i rëndësishëm.

"Takime si ky na japin emocion dhe janë rikujtues i kohëve të vështira të angazhimit të përbashkët për liri. Kur po luftonim me bashkëluftëtarë kundër së keqes që i kanosej vendit tonë, ndihma nga ajri përmes

NATO-s ishte vendimtare për përmbylljen e luftës. Wesley Clark po komandonte forcat e NATO-s në ndërhyrjen humanitare që do ta ndryshonte përgjithmonë të ardhmen e vendit tonë", u shpreh ministri Maqedonci.

PSD-ja zhvillon aksion me fotografi të Liburn Aliut: "Po pritoj me fol për autostradë"

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Partia Socialdemokrate ka zhvilluar të enjten një aksion me fotografi të ministrit të Infrastrukturës, Liburn Aliut, me mbishkrimet "Po pritoj me fol për autostradë". "Një rajon i tërë ka mbetur peng i përteses së Liburn Aliut. Thanë që autostrada është thujse e përfunduar e pastaj që premtimi ishte i gabuar se kryeministri u vu në lajthitje. Sot e asaj dite, plot një mandat dhe autostrada është

e papërfunduar, e Anamorava, nëse jo e izoluar, rrezikon jetën në rrugën e vjetër për Prishtinë e pa urë në Badovc. Ministër, ti edhe përteton me fol për autostradën, por ne jo. Të vetmit që u vunë në lajthitje janë qytetarët e Gjilanit, Kamenicës e Vitisë, të cilëve nuk prituat t'ua kapni votën me premtime e mashtrime", ka shkruar në "Facebook" kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj.




Komuna e Gjilanit mbështet me 150 mijë euro 293 studentë

GJILAN, 14 NËNTOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka bërë me dije se kanë hapur konkursin për ndarjen e bursave studentore për vitin akademik 2023/2024. "I kemi 293 bursa në vlerë prej 150 mijë eurosh", tha Hyseni. I pari i komunës tregoi se 164

prej bursave janë në vlerë 720 euro në vit ose nga 60 euro në muaj për studentët të cilët studiojnë jashtë Gjilanit. Sipas tij, 109 bursa të tjera janë për ata që studiojnë brenda qytetit tonë në vlerë prej 480 eurosh në vit ose nga 40 euro për muaj. Janë edhe 20 bursa në vlerë

prej 480 eurove në vit, ose nga 40 euro në muaj për studentët e studimeve master. "Studentët e superpërkushtuar, jemi për t'i mbështetur e përkrahur. Vazhdoni të na bëni krenarë, aplikoni për bursa", ka përfunduar kryetari Alban Hyseni.



Dallimet midis demokratëve dhe republikanëve në ShBA për Kosovën dhe integrimin e saj në organizata ndërkombëtare



Nga Washington DC, shkruan: Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

Sipas burimeve nga administrata amerikane këtu në Washington DC, mund të vërehen disa dallime kyçe midis politikave të Demokratëve dhe Republikanëve në lidhje me Kosovën dhe

integrimin e saj në organizata ndërkombëtare. Këto dallime pasqyrojnë ndryshimet në prioritetet strategjike dhe vlerat ideologjike të secilës parti. Demokratët kanë treguar mbështetje të vazhdueshme për përfshirjen e Kosovës në organizata ndërkombëtare, duke e konsideruar si një hap të rëndësishëm për sigurinë dhe

stabilitetin në Ballkan. Kjo mbështetje ka qenë një pjesë e rëndësishme e politikës demokratike që nga administratat e hershme, si ato të Jimmy Carter dhe Joe Biden. Administrata e Jimmy Carter (1977-1981): Përqendrimi në të drejtat e njeriut gjatë kësaj periudhe ka krijuar një themel mbështetjeje për shqiptarët e

Kosovës. Administrata e John F. Kennedy (1961-1963): Prioriteti ndaj lidhjeve me Bashkimin Evropian dhe partnerëve të tjerë për stabilitetin rajonal ndikoi indirekt në mbështetjen ndaj Kosovës. Administrata e Lyndon B. Johnson (1963-1969): Theksoi të drejtat e njeriut dhe demokratizimin, duke kontribuar në mbështetjen morale për çështjet shqiptare në Kosovë. Qasja e Republikanëve ndaj Kosovës Republikanët, nga ana tjetër, kanë ndjekur një qasje më pragmatike ndaj Kosovës, duke i dhënë përparësi stabilitetit afatshkurtër dhe interesave strategjike të ShBA-së. Në vend të përfshirjes së Kosovës në organizata ndërkombëtare, ata shpesh janë fokusuar në marrëveshje ekonomike dhe stabilitet të menjëhershëm. Administrata e Ronald Reagan (1981-1989): Në kontekstin e luftës kundër komunizmit, Reagan mbështeti forcat që sfidonin ndikimin sovjetik, duke përgatitur terrenin për mbështetje ndaj Kosovës. Administrata e Richard Nixon (1969-1974): Diplomacia e fuqisë ishte kryesore gjatë kësaj kohe, duke shmangur angazhimet e drejtpërdrejta në rajon. Administrata e George H. W. Bush (1989-1993): Në përpjekje për paqe pas rënies së Bashkimit Sovjetik, Bush ndjek një qasje të kujdesshme ndaj Ballkanit. Dallimet Kryesore Midis Demokratëve dhe Republikanëve Demokratët mbështesin fuqimisht anëtarësimin e Kosovës në organizata si NATO dhe OKB, duke e parë këtë si një garanci për stabilitetin në Ballkan. Republikanët janë më të përqendruar në marrëveshje

bilaterale dhe përfitime ekonomike afatshkurtra. Demokratët mbështesin një qasje të koordinuar me BE-në, duke e konsideruar atë si një partner kryesor për sigurinë në Ballkan. Republikanët shpesh ndjekin një qasje më të pavarur, duke u fokusuar në interesat amerikane mbi politikën e BE-së. Demokratët vlerësojnë të drejtat e njeriut dhe demokracinë, duke parë Kosovën si një kauzë që reflekton vlerat amerikane. Republikanët janë të orientuar nga stabiliteti dhe përfitimet ekonomike afatshkurtra, siç u pa në marrëveshjet ekonomike të ndërmjetësuara nga Donald Trump. Administrata e Joe Biden (2021 - aktualisht): Biden ka vazhduar të mbështesë përpjekjet e Kosovës për integrim ndërkombëtar në bashkëpunim me BE-në, duke promovuar dialogun Kosovë-Sërbi dhe duke theksuar rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në NATO për stabilitetin evropian. Administrata e Donald Trump (2017-2021): Trump pati një qasje më të fokusuar në aspektin ekonomik dhe pragmatik. Marrëveshja e Washingtonit e vitit 2020, që u përqendrua në zhvillim ekonomik dhe normalizim përmes investimeve, është shembulli më i mirë i kësaj qasjeje, duke vënë theksin te përfitimet ekonomike dhe stabiliteti afatshkurtër. Në përmbledhje, Demokratët mbështesin integrimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare si pjesë e një strategjie për sigurinë dhe stabilitetin në Ballkan. Ndërsa Republikanët preferojnë një qasje më pragmatike dhe të orientuar nga stabiliteti dhe përfitimet ekonomike afatshkurtra.

Komisioni i posaçëm procedon për seancë pesë kandidatë për emërim në Kushtetuese

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Pas rezultateve të intervistimit me gojë, komisioni i posaçëm për shqyrtimin e

kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese ia rekomandon të pesë kandidatët seancës së

Kuvendit për votim, të radhitur sipas rezultatit të poentimit, si në vijim: 1. Flamur Mrasori; 2. Ardita

Haxhnikaj-Demi; 3. Avdyllkadër Muçaj; 4. Selman Ymeri dhe 5. Ramadan Gashi.



Kosovë - Suedi, diskutohet për projektet e përbashkëta në sektorët ekonomikë

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, priti në takim ambasadorin jorezident të Kanadasë në Kosovë, Jessica Blitt, me të cilën diskutuan për marrëdhëniet diplomatike ndërmjet dy vendeve, sfidat e sigurisë në rajon dhe rolin mbështetës të Kanadasë për paqen dhe stabilitetin në Ballkan.

Ministrja Gërvalla shprehu mirënjohjen e saj për mbështetjen e vazhdueshme të Kanadasë për Kosovën dhe

përkushtimin për t'i thëlluar marrëdhëniet ndërshtetërore përmes bashkëpunimeve të reja jo vetëm në politikën e jashtme, por edhe në ekonomi, arsim dhe teknologji. Investimet strategjike dhe projektet e përbashkëta në sektorët ekonomikë, kulturorë dhe të sigurisë u vlerësuan si mundësi konkrete për ta avancuar më tej bashkëpunimin mes dy vendeve, me mërgatën tonë si një garanci për marrëdhënie të fuqishme në mes të Kosovës dhe Kanadasë.



Hamza zotohet për mbështetje të bizneseve: Paga më të larta e tatime më të ulëta

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka vlerësuar se bizneset e Kosovës kanë nevojë për më shumë mbështetje. Ai ka

vlerësuar se kjo do të jepte më shumë siguri për punëtorët. Hamza ka shkruar në "Facebook" se bizneset duhet të kenë tatime më të ulëta. "Më shumë mbështetje për

bizneset. Më shumë siguri për punëtorët. Paga më të larta e tatime më të ulëta! Kosova mundet ma mirë! Ma mirë për të gjithë!", ka shkruar Hamza.



Rreth 10 për qind e popullatës në Kosovë e prekur nga diabeti

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Diabetit, në Prishtinë ka filluar të enjten fushata për sensibilizimin e popullatës rreth parandalimit dhe menaxhimit të diabetit. Drejtori i Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës, Izet Sadiku, ka thënë se mënyra më e mirë për mbrojtje nga diabeti është parandalimi. "Drejtorja e Shëndetësisë në kryeqytet, sikurse për sëmundje të tjera, edhe në Ditën Botërore të Diabetit po organizon një fushatë sensibilizuese, e cila do të zgjasë diku 10 ditë. Sot kemi filluar vendosjen e rrethit të kaltër, i cili simbolizon ngjyrën e unifikimit rreth kësaj problematike dhe ngjyrën blu të qiellit. Pastaj kemi filluar me brendimin e autobusit të



trafikut urban, i cili jep informata për qytetarët, kemi vendosur karvanin shëndetësor, i cili do të jetë i

vendosur sot në shesh, pastaj do të jetë i vendosur në 'Albi Mall' të shtunën, si dhe do të jetë dhe të dielën në 'Vila

Gërmi', me qëllim që të takojë sa më shumë qytetarë dhe të japë sa më shumë informata, të matet diabeti", ka thënë

Sadiku. Ai ka bërë me dije se kjo fushatë do të vazhdojë edhe javën tjetër me ligjërata për pacientët që janë me diabet. "Do të mbahen pesë ligjërata në bashkëpunim me shoqatën e Endokrinologëve dhe Klinikën e Endokrinologjisë. Javën e ardhshme do të fillojmë edhe ndërtimin e Qendrës Këshillimore për Sëmundje Kronike dhe Diabet, e cila do të jetë këshillimorja e parë në kryeqytet për sëmundje kronike", ka pohuar Sadiku, duke shtuar se ka shumë interesim nga qytetarët që ta matin diabetin. Ai i ka ftuar qytetarët të bëjnë analiza për arsye se duke i bërë analizat, do të jetë e mundur të dihet gjendja dhe të diagnostifikohet sëmundja.

Haxhiu bisedon me krerët e sistemit të drejtësisë për reformën në drejtësi

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka mbajtur të enjten një takim me drejtuesit e sistemit gjyqësor, sistemit prokurorial si dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë nga Zyra e BE-së, Ambasada Amerikane në Kosovë, Këshilli i Evropës dhe OSBE-së. Në takim është diskutuar për reformën në drejtësi, për veprimet e mëtutjeshme

lidhur me paketën ligjore, gjashtë projekt-aktet normative të cilat rrjedhin nga Deklarata e Përbashkët e Zotimeve. Ministrja Haxhiu fillimisht i falënderoi të gjithë aktorët për kontributin e tyre në finalizimin e paketës së tillë ligjore dhe, gjithashtu, theksoi rëndësinë e procedimit tutje, si hap tjetër i rëndësishëm i reformës në drejtësi.

Në takim, mes të tjerash, gjithashtu është diskutuar për rëndësinë dhe mundësinë e konsultimit të paketës ligjore me Komisionin e Venedikut, marrë parasysh edhe rekomandimet e raportit për vendin. E tërë kjo po bëhet në mënyrë që paketa ligjore të jetë në përputhje të plotë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.



Guvernatori Ismaili në Tiranë flet për reformat e ndërmarra nga BQK-ja

TIRANË, 14 NËNTOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, ka marrë pjesë si folës në panel në Konferencën Vjetore me temë "Roli i Bankës Qendrore dhe sistemit bankar në rrugën drejt BE-së", e organizuar në Tiranë nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave. Në këtë konferencë të nivelit të lartë morën pjesë drejtues dhe zyrtarë të lartë të institucioneve financiare ndërkombëtare, si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, guvernatorë dhe përfaqësues të botës akademike. Gjatë takimit u diskutuan dhe shkëmbyen pikëpamjet dhe përvojat e bankave qendrore në ndërtimin e rrjeteve



efektive institucionale për një integrim të suksesshëm në Bashkim Evropian, ashtu si dhe përpjekjet bashkëpunuese ndërmjet bankave qendrore të Ballkanit Perëndimor nën

udhëheqjen e Bankës Qendrore Evropiane. Guvernatori Ismaili mori pjesë në panelin e guvernatorëve me temë "Udhërrëfyesi institucional dhe rrjetet efikase",

kryesuar nga Poul Thomsen, ish-drejtor i Departamentit Evropian i Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Paneli përfshinte guvernatorë nga Banka e Shqipërisë, Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe asaj të Malit të Zi.

Gjatë fjalës së tij, guvernatori Ismaili diskutoi për mënyrën e adresimit të sfidave në vitet e fundit, treguesit kyçë makroekonomikë dhe zhvillimet në sektorin financiar. Ai elaboroi mbi reformat e ndërmarra nga BQK-ja për avancimin e kornizës ligjore në drejtim të përafritimit me vendet evropiane si dhe nismat e marra në rritjen e qëndrueshmërisë së vendit.

Më tutje, guvernatori Ismaili në këtë panel ka folur edhe për progresin dhe hapat e ndër-

marrë nga BQK-ja për ta integruar Republikën e Kosovës në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA).

Konvergjenca me BE-në sjell përfitime të mëdha për sektorin financiar dhe ekonominë e vendit në përgjithësi, prandaj BQK-ja mbetet e përkushtuar për ndërmarrjen e reformave që përafrojnë sektorin financiar me atë të vendeve të BE-së. BQK-ja është në proces të vazhdueshëm të harmonizimit të legjislacionit me rregulloret dhe direktivat e BE-së si dhe praktikat mbikëqyrëse të autoriteteve rregullative evropiane, ndërsa vazhdon t'i forcojë marrëdhëniet e bashkëpunimit me bankat qendrore të rajonit dhe të BE-së, si dhe me institucionet financiare ndërkombëtare.

Përfaqësues të ATK-së marrin pjesë në takimin rajonal për Menaxhimin e Riskut të Përmbushjes (MRP)

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Dy përfaqësues nga Administrata Tatimore e Kosovës, Sami Salihu dhe Agron Hamiti, janë duke marrë pjesë në takimin rajonal "Menaxhimi i Riskut të Përmbushjes (MRP) në Evropën Juglindore (EJL) - Komuniteti i Praktikës (CoP)" në Slloveni.

Ky aktivitet është duke u mbajtur në kuadër të programit të Departamentit për Çështje Fiskale për zhvillim të kapaciteteve për Reformën Fiskale në Evropën Juglindore (EJL), të financuar nga Komisioni Evropian dhe Sekretariati Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO), i cili mbulon gjashtë vendet e EJL-së (Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë) në tri fusha të punës: menaxhimi i financave publike,

administrimi i të ardhurave/të hyrave dhe politika tatimore. Komuniteti i Praktikës (CoP) mbledh së bashku administratat tatimore të EJL-së për të kontribuar, konfirmuar dhe mësuar nga përvojat e tyre kolektive në zbatimin dhe funksionimin e proceseve të MRP-së si një mekanizëm për ta përmirësuar përmbushjen e tatimpaguesve. Përmirësimi i aftësive të pjesëmarrësve përfshin të kuptuarit e procesit të MRP-së, duke përfshirë përfitimet dhe kufizimet e tij; të kuptuarit e praktikave të mira/të këqija në zbatimin praktik të procesit të MRP-së; ofrimin e mundësisë që pjesëmarrësit t'i ndajnë njohuritë e tyre duke ndihmuar pjesëmarrësit të krijojnë bashkëpunim në mes tyre për të vazhduar CoP, që të sjellin vlerë për të gjitha administratat në rajon.



Qeveria miraton pesë vendime të sponsorizuara nga Ministria e Financave

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Në mbledhjen e fundit të qeverisë u miratua nisma për negociimin e marrëveshjes me Komisionin Evropian për Mekanizmin për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor. Kjo marrëveshje ka vlerë prej 882.6 milionë eurosh, ku rreth 253 milionë euro janë grante, ndërsa pjesa tjetër është kredi. Marrëveshja synon realizimin e reformave të ndryshme për menaxhimin e financave publike, digjitalizimin e shërbimeve publike dhe infrastrukturës, politikën e dekarbonizimit,



eficiencën e energjisë, rregullimin e mjedisit afarist, arsimin, tregun e punës dhe sundimin e ligjit.

U miratua edhe ndarja prej 7.3 milionë eurosh si mbështetje për Fondin Kosovar për Garanci Kreditorë në kuadër të

masës 2.2, në mënyrë që bizneset dhe ekonomia e vendit të kenë qasje më të lehtë në financa, duke mos pasur nevojë të ofrojnë hipoteka apo pengje të tjera si garanci. Po ashtu, u miratua raporti nëntëmujor për performancën e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore ku, ndër të tjera, të hyrat nga ATK ishin 10 % më shumë, si dhe të hyrat nga Dogana ishin 11 % më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, apo 191.4 milionë euro më shumë të arkëtuara. Gjithashtu, shpenzimet për paga dhe shtesa kishin një rritje

prej 13 %, ndërsa ato për investime kapitale rritje prej 23 %.

U miratua plotësim-ndryshimi i Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit. Ky ligj, ndër të tjera, parasheh luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit përmes zbatimit të sanksioneve dhe masave parandaluese. Po ashtu, u zëvendësua kryesuesi i Komisionit për Përfitim të Punës, vendim i miratuar më 16 shkurt 2023.

Biznesi dhe Roma e lashtë: Fiksimi i Elon Musk me Italinë

Obsesioni italian. Miqësia e tij me Xhorxhia Melonin, që në sytë e tij është "edhe më e bukur brenda se jashtë". Sfida (e dështuar) në arenën e Koloseut me Mark Zuckerbergun, gladiatorin tjetër të mediave sociale globale. Takimi me Papa Françeskun në Vatikan. Dhe buqeta me lule e vendosur në qytetin e përjetshëm, mbi tumën ku në vitin 44 p.e.s. u dogj kufoma e Jul Cezarit, me atë shënim madhështor në latinisht: «Per aspera ad astra. Elon.»

Yjet që Elon Musk aspiron të arrijë "përmes vështirësive" janë (gjithashtu) ata të Bel Paese. Për njeriun më të pasur në botë, pothuajse një alter ego e Donald Trump, Italia është tashmë një obsesion i vërtetë. Tweet-i për të kërkuar largimin e gjykatësve që ndaluan procedurat e



përshpejtuara për riatdhesimin e emigrantëve, është vetëm postimi i fundit që konfirmon vëmendjen e Elon Musk ndaj Italisë.

Nuk është hera e parë. Një muaj më parë, përsëri në ish-Twitter-in që bleu dhe në të cilin investoi edhe Unipol, Musk e

kishte cilësuar si "të pakuptimtë" vendimin e Gjykatës së Romës për vendet e sigurta dhe kishte mbrojtur Salvinin në gjyqin për Open Arms: "Ai prokuror i çmendur duhet të shkojë në burg për gjashtë vjet", shkroi ai. Historia e Romës së lashtë e

intrigon, spageti e kënaq, seriali televiziv "Roma" i HBO dhe BBC e magjeps, marrëdhëniet e tij me kryeministren mund të jenë të dobishme për të në marrëdhëniet me Brukselin. Dhe Italia, siç guxoi të thotë Tajani gjatë takimit të tyre, "është vendi më i mirë evropian në të cilin mund të investohet". Miliardi vizionar që magjeps të djathtën Meloniane dhe tmerron shumë të majtën, po bën llogaritë e tij. Emisarët e Starlink, Tesla dhe SpaceX shpjegon pjesërisht pse Musk, i cili ka lindur njëmbëdhjetë fëmijë, nuk lodhet kurrë së thirruri, për të bindur italianët të ndryshojnë kurbën e lindshmërisë.

"Duhet të keni më shumë fëmijë", kërkoi ai dhjetorin e kaluar nga skena e festës Atreju, ku u ngjit me një fëmijë mbi

supë: "Italia është një vend i jashtëzakonshëm, por ndoshta lindshmëria është e ulët. Nëse një kompani duhet të investojë, pyet veten nëse do të ketë mjaftueshëm njerëz që do të punojnë..."

Një pyetje që do të tingëllonte si futje hundësh, nëse nuk do të ishte fakti që pas investimit tek Trump, pavarësisht shpenzimeve, kapitali i Musk është rritur në 304 miliardë dollarë. Dhe nëse vendos të vërë bast disa qindarka për Italinë, do të jenë gjithësesi shumë para. Mjafton të kujtojmë dialogun e nisur nga Palazzo Chigi me Starlink për furnizimin e satelitëve që do të garantonin lidhje të sigurta me institucionet italiane: një marrëveshje e cila, nëse firmoset, do të zgjasë 5 vjet dhe do të kushtojë 1.5 miliardë. / bota.al

Çfarë do ndryshojë me ardhjen e Trusk (Trump + Musk)

Pasi komunikimi është dobësuar, gjyqësori është frenuar, intoleranca është përhapur dhe legjitimuar me fjalë që deri dje nuk thuheshin, ne e gjejmë veten aty ku blloku Trusk u tha me sineritet votuesve se donte të shkonte: drejt një bote tjetër. Nuk mund t'i fajësosh për dinakëri apo maskim të qëllimeve. Truskët e deklaruan qartë strategjinë e tyre dhe arritën sukses zgjedhor me atë projekt

Walter VELTRONI

Kam dëgjuar shumëkënd të thotë, nga katër vitet e para të Trumpit, dhe në epokën e furishme dixhitale, çfarë ndryshoi në krahasim me Obamën?

Po, ndodhën gjëra të tilla si revokimi i marrëveshjeve për klimën dhe sabotimi i Medicare të Obamës me manovra që sollën më shumë se dy milionë njerëz pa sigurim shëndetësor. Por në fusha të tjera, të politikës financiare apo të marrëdhënieve ndërkombëtare, nuk janë parë ndryshime të rëndësishme dhe rrënjësore mes administratave të ndryshme.

Por mendoj se këtë herë do të jetë ndryshe. Unë besoj se mes boshtit të mendimit prej millennial-i të Elon Musk dhe sugjerimeve apokaliptike të Steve Bannon-it, do të shohim një kohë ndryshimesh thelbësore dhe jo vazhdimësie. Do të ndodhë në Ukrainë dhe do të jetë interesante të ndjekim politikën evropiane kur Zelensky të mbetet vetëm, dhe të gjithë të jemi të varur prej

vetëkontrollit ekspansionist të Vladimir Putinit. Me shpresën se ai nuk ka ndërmend të shkojë përtej pushtimet ushtarake – tashmë të siguruara.

Bota nuk është më në ekuilibrin e së shkuarës dhe gjithçka është e mundur. Putini e kuptoi qartë këtë, duke folur për gjendjen e paprecedentë geopolitike dhe duke kultivuar idenë e një madhështie të rigjetur ruse, me krijimin e një fuqie euroaziatike të aftë për të konkurruar me gjigantët kinez.

Bota po ndryshon ekuilibrat e saj dhe në këtë kontekst procesi i dobësimit të Bashkimit Evropian, i gërryer nga sovranizmi dhe nacionalizmi populist në shtetet anëtare, është funksional për një strategji të ribërjes së marrëdhënieve të fuqisë ekonomike dhe financiare.

Nëse NATO është më e dobët, nëse strategjitë e integritimit autentik evropian – politikë dhe mbrojtjes dhe ato buxhetore – do të lihen pas dore, do të shfaqet perspektiva e një bote të përbërë nga tre fortesa, Rusia, Kina dhe SHBA-ja. Steve Bannon e tha shumë qartë në intervistën iluminuese



me Viviana Mazza-n: "Po, detyra të reja po vijnë. Do të duhet të paguash për të pasur akses në tregun amerikan. Nuk është më falas, tregu i lirë ka marrë fund".

Unë besoj se strategjia e bllokut Trusk është më e gjerë dhe duhet marrë në konsideratë ashtu siç është, pa reduktime arrogante në folklorin e një linje që ushqehet me analiza, mjete dhe synime të qarta.

Demokracia, si një mekanizëm i bazuar në votën popullore dhe ndërmjetësimin e përfaqësuar me delegim, duke filluar nga parlamentet, është një gjë e shenjtë dhe e papajtueshme për një shoqëri të çastit si ajo dixhitale..

Nga ky këndvështrim, është paradoksale që kritika e globalizimit bazohet në postulatit se i vetmi dimension universal i lejuar është ai i tregjeve teknologjike, të paktën në sferën e konsumit dhe në dinamikën komunikuese dhe të marrëdhënieve, me mediat sociale të kthyera në një sallë



globale. Musk kohët e fundit ka argumentuar se gazetat dhe televizioni nuk shërbejnë për të garantuar komunikimin, se e vetmja e vërtetë e mundshme është ajo e prodhuar nga dhjetëra miliona njerëz që në të njëjtën kohë ngarkojnë këndvështrime dhe lajme në internet, pak rëndësi ka nëse ato janë të bazuara apo jo në realitet. Njëqind mijë që bëhen askush dhe një, vetëm një, që vendos.

Skema është e njëjtë me atë që zbatohet në politikë: lejimi i një zhurme konfuze në sfond, sado kritike të jetë, ndërkohë që një njeri merr vendime në emër të popullit. Në mënyrë të ngjashme, në mediat sociale, algoritmet rregullojnë ekuilibrin e pushtetit, midis individëve të izoluar dhe makinerive të sofistikuar që përmbysin Internetin me lajme, reale apo të shpikura, në të cilat konsumohet nevoja për njohuri dhe iluzionet e marrëdhënieve. Pasi komunikimi është

dobësuar, gjyqësori është frenuar, intoleranca është përhapur dhe legjitimuar me fjalë që deri dje nuk thuheshin, ne e gjejmë veten aty ku blloku Trusk u tha me sineritet votuesve se donte të shkonte: drejt një bote tjetër. Nuk mund t'i fajësosh për dinakëri apo maskim të qëllimeve. Truskët e deklaruan qartë strategjinë e tyre dhe arritën sukses zgjedhor me atë projekt.

Shpejt dhe furishëm. Të martën e parë të nëntorit nuk fituan thjesht republikanët, diçka më shumë po lind: një projekt pushteti revolucionar për këtë kohë.

Të belbëzosh refuzimin e gjithë kësaj në emër të korrektësisë politike ose të diskutosh me pasion nëse, në të majtë, duhet të jemi më të moderuar apo më ekstremistë, është një humbje kohe. Roosevelt, me Musolinin në pushtet dhe Depresionin e Madh në vendin e tij, nuk ndenji duarkryq. Krijoi New Deal (Marrëveshjen e Re). / Në shqip nga bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit



Kosova synon fitore në 'finalen' ndaj Rumanisë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll sonte (e premte) e zhvillon ndeshjen kryesore në Ligën e Kombeve. "Dardanët", që arritën të enjten në Bukuresht, do të përballen me Rumaninë nga e cila ndeshje presin fitore me rezultat bindës në mënyrë që të mbesin në garë për vendin e parë në grup. Përzgjedhësi Franco Foda ka thënë se duhet ta fitojë ndeshjen për faktin se vendi i parë është ende i mundshëm. "Detyra ime është ta përgatis ekipin. Vitin e kaluar nuk kam qenë trajner, por kemi parë respekt nga ekipet kombëtare edhe në kampionatin evropian, andaj pres respekt edhe nga Rumania", ka thënë Foda. "Vendi i parë akoma është i mundshëm, por për ta arritur këtë duhet ta fitojmë ndeshjen me Rumaninë. Në tri ndeshjet e

fundit kemi treguar lojë të mirë. Jam përgjithësisht i kënaqur, por jo edhe tepër i kënaqur, sepse është dashur të përmirësohemi dhe të shënojmë më shumë gola. Për shkak të lëndimeve duhet t'i bëjmë disa përshtatje në ekip, por nisemi me vetëbesim dhe energji shumë pozitive në Rumania. Jemi të gatshëm dhe dëshirojmë të fitojmë. Pastaj, mbetet të shihet në ndeshjet e fundit se kush do të jetë në pozitën e parë në grup", ka shtuar Foda, i cili ka paralajmëruar se "dardanët" edhe në këtë ndeshje do të luajnë futboll ofensiv. "Përgjithësisht do të jemi ofensivë. Duhet t'i shfrytëzojmë të gjitha fazat e lojës. Kundër Rumanisë në ndeshjen e parë nuk kemi pasur fat. Në momentet e vështira kemi pësuar gol. Parimisht do të luajmë si në shtëpi si jashtë, pra me lojë ofensive", ka shtuar Foda.

Për ndeshjen ndaj Kosovës ka folur trajneri i Rumanisë i Kombëtares së Rumanisë, Mircea Lucescu, i cili ka theksuar se Kosova ka disa lojtarë të rëndësishëm në ekip, ku me theks të veçantë ka folur për Edon Zhegrovën, i cili, sipas tij, është i jashtëzakonshëm. "Zhegrova është lojtar i jashtëzakonshëm nëse i lejohet të luajë. E mbyllëm mirë në Prishtinë. Në Evropë, në kampionat, ku i lejohet të luajë, është vendimtar. Kosova ka 3-4 lojtarë të rëndësishëm aty. Rrahmani, Berisha, Muriqi dhe Zhegrova janë më të rëndësishmit", ka thënë Lucescu. "Shpresoj të mos bëni shaka me Kosovën. Kosova është një ekip i madh që mund të fitojë kundër çdo skuadre. Fakti që nuk arritën të bënin një grup të fortë, nuk do të thotë se nuk janë një ekip i rëndësishëm. Nuk ka më një gjë të tillë, vetëm ne e imaginojmë...", Lucescu.

Odise Roshi pensionohet nga Kombëtarja e Shqipërisë

Tiranë, 14 nëntor - Pas Bekim Balajt, futbollisti i radhës që tërhiqet nga Kombëtarja e Shqipërisë, është Odise Roshi, i cili ka pasur një karrierë të gjatë me ngjyrat kuqezi. Roshi ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për ekipin kombëtar, duke dhënë gjithmonë maksimumin e tij në arritjet historike të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Gjatë gjithë karrierës së tij me kuqezinjët, ai është njohur edhe me nofkën. "Raketa" nga tifozët,

numëron 71 ndeshje dhe 5 gola, ndërsa ishte pjesë e skuadrës në kualifikimin historik në "Euro 2016" dhe pjesë e saj në finalen e Evropianit. "Federata e Futbollit e falënderon Roshin për të gjithë kontributin e dhënë ndër vite me fanellën kuqezi, ku do të kujtohet gjithmonë për asistimet e tij vendimtar, shpejtësinë dhe energjinë e tij në fushë. I urojmë Odise Roshit suksese të mëtejshme në karrierën e tij", thuhet në njoftimin e FShF-së.



SHKURT

Kosova U19 pëson humbje nga Austria

Përfaqësuesja U19 e Kosovës në futboll ka pësuar humbje nga Austria me rezultat 4-0 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, në ndeshjen e parë në kuadër të Grupit 10 për kualifikimet e Evropianit 2025. Në pjesën e parë austriakët zhblllokuan shifrat, kur Phillip Verhounig shënoi me gjuajtje të fortë nga brendësia e zonës për rezultat 0-1. Kosova në pjesën e dytë ishte insistuese për ta kthyer rezultatit, por austriakët shfrytëzuan hapësirat e krijuara. Verhounig, Gërgjiq, dhe Adejenughure realizuan golat e tjerë për austriakët. Ndeshjen e radhës Kosova e zhvillon kundër Spanjës pas tri ditësh, po ashtu në orën 15:00, në stadiumin "Fadil Vokrri".

Zëvendësministrja Daulina Osmani inspekton punët në stadiumin e Gjakovës

Zëvendësministrja e Sportit, Daulina Osmani, vizitoi të enjten qytetin e Gjakovës. Ajo u takua me kryetarin e komunës së Gjakovës, Ardian Gjini. "Bashkë diskutuan për përgatitjet që po bëhen në kuadër të organizimit të Lojërave Mesdhetare si dhe projektet e përbashkëta në mes të MKRS-së dhe komunës së Gjakovës. Pas takimit vizituan stadiumin e qytetit për t'i parë nga afër punimet që po zhvillohen aty", thuhet në njoftimin e MKRS-së. Qyteti i Gjakovës së shpejti do ta ketë stadiumin modern të nivelit ndërkombëtar. Ky stadium me investim prej 9 milionë eurosh është duke u ndërtuar në kuadër të planit pesëvjeçar të infrastrukturës sportive të futbollit dhe do të shërbejë për Lojërat Mesdhetare 2030.

Mesfushori i Çekisë: Goli e kam ruajtur për ndeshjen ndaj Shqipërisë

Çekia është në përgatitjet e fundit përpara ndeshjes shumë të rëndësishme, që e pret të shtunën në mbrëmje në Tiranë, përballë Shqipërisë. Në prag të kësaj përballje shumë të rëndësishme për ta, ka folur edhe mesfushori Pavel Sulc. 23-vjeçari që luan në kampionatin çek me Plzenin ka kërkuar menjëherë ta "ndeze" situatën duke lëshuar edhe një premtim për tifozët çekë për sfidën ndaj kuqezinjëve. "Është gjithmonë mirë kur gjithçka është në dorën tonë. Besoj se mund ta përballojmë ndeshjen e së shtunës. Nuk e di si do të shkojë, por rëndësi ka që i kemi gjërat në dorën tonë. Unë jam duke luajtur një pozicion pak më ndryshe sesa luajta sezonin e kaluar. Dikur luajta thjesht si sulmues, tani luaj si 8-sh. E kam ruajtur golin për ndeshjen ndaj Shqipërisë", ka thënë Sulc.

Fitorja e shtatë rresht për Rahovecin

Kampioni i Kosovës në hendboll, Rahoveci, ka vazhduar me bilanc të qindpërqindtë. Të mërkurën mbrëmëra në Shtime, Rahoveci e mposhti Vjosën me rezultat 38:21. Ishte kjo ndeshje e mbetur e xhiros së gjashtë. Ndeshja ishte shtyrë për shkak të angazhimeve evropiane të Rahovecit. Aloja Mali Luzha i realizoi tetë gola për Rahovecin. Nga shtatë i shënuan Jon Muqolli e Alban Haziri. Te Vjosa shumicën e golave, 13 i shënoi Festim Mustafa. Katër i kishte Erblin Qerimi. Rahoveci ka shtatë fitore rresht dhe udhëheq në tabelë me 14 pikë, dy më shumë se Besa Famgasi e Kastrioti. Vjosa është e shtata me katër pikë. E pësoi humbjen e gjashtë.

Zidane elozhe për Bellinghamin: Është shumë i fortë, do të sjellë shumë tituj në 'Bernabeu'

MADRID, 14 NËNTOR - Anglezit Jude Bellingham i mjaftoi vetëm një sezon për t'u shndërruar në idhullin e tifozëve të Real Madridit. Britaniku ka justifikuar deri më tani çdo qindarkë investimi të Florentino Perez duke u

dhuruar madrilenëve gola, asistime, si dhe shumë fantazi. Një lojtar i kompletuar që së fundmi fiton edhe elozhet e një si Zinedine Zidane, me "legjendën" e Real Madridit, i cili në një koment të shkurtër për

mediet është shprehur se e konsideron talentin anglez një lojtar spektakolar, shumë të fortë, që sjell një numër të mëdhenjsh titujsh në "Santiago Bernabeu". "Është një lojtar me të vërtetë special. Të gjithë ne ndihemi me shumë fat që ai

është pjesë e Real Madridit. Është shumë i fortë dhe unë shpresoj që do t'i sjell shumë tituj skuadrës", u shpreh një prej lojtarëve, më të mirë në historinë e "Los Blancos". Interesant është fakti se Bellinghami te Reali mban veshur fanellën



me numër pesë, e cila i përkiste edhe Zidane.

Clevelandi regjistron fitoren e 13 radhazi, fitojnë edhe Bostoni, Bucks-i e Oklahoma

PHILADELPHIA, 14 NËNTOR - Cleveland Cavaliersi nuk njih rivalë këtë sezon. Ndaj Philadelphia 76-ers, Cavaliersi arriti të fitonte të 13 ndeshjet radhazi këtë sezon, duke qenë ende i pathyeshëm. Cavaliersi fitoi me rezultat 114-106 në fushën e Philadelphia, ku dyshja Garland - Mitchell realizoi 48 pikë së bashku. Për vendast rezultuan të pamjaftueshme 34 pikët dhe 10 asistimet e McCainit, me Philadelphia që nuk është më e njëjta skuadër, kur i mungon ylli Embiid. Pas kohës shtesë triumfoi ekipi i Milwaukee, që mundi me rezultat 127-210 Detroitin, ndeshje ku Antetokounmpo realizoi 59 pikë e 14 rebounde.



Fitoi edhe skuadra e Bostonit, që mundi me rezultat 139-114 Brooklynin jashtë fushës, falë 36 pikëve të Jayson Tatumit, 10 pasime të sakta dhe 9 topa në tabelë. Në këtë mënyrë kampionët në fuqi të Boston Celticsit duket se janë për momentin të vetmit në gjendje për ta ndjekur ecurinë mbresëlënëse të kryesuesve të Konferencës së Lindjes, Cleveland Cavaliers. Moment të mirë po kalon edhe ekipi i Lakersave, që mposhti me

rezultat 128-123 Memphisin. LeBron James magjik me një "triple double", teksa ai realizoi plot 35 pikë, 12 rebounde dhe 14 asistime, për fitoren e radhës së kalifornianëve ndaj Memphis Grizzliesit me rezultat 128-123. Oklahoman merr kreun e renditjes në Perëndim pas fitores 106-88 ndaj New Orleansit. Lojtari më i dalluar për (Williams 31 pikë). Me këtë fitore Oklahoman rimer kryesimin në Konferencën e Perëndimit, duke parakaluar Golden State.

REZULTATET

Orlando - Indiana	94-90
Brooklyn - Boston	114-139
New York - Chicago	123-124
Oklahoma - New Orleans	106-88
Philadelphia - Cleveland	106-114
Houston - Clippers	111-103
Milwaukee - Detroit	127-120
San Antonio - Washington	139-130
Lakers - Memphis	128-123
Portland - Minnesota	106-98
Sacramento - Phoenix	127-104

Vasseur: Ishte shumë e lehtë ta bindja Hamiltonin të vinte te Ferrari

MARANELLO, 14 NËNTOR - Sezoni 2024 në Formula 1 është drejt fundit dhe mjaft skuadra janë duke menduar që tani për atë që do të ndodhë nga pranvera e ardhshme. Ndryshimi më i madh do të jetë padyshim kalimi i Lewis Hamiltonit te Ferrari, me 7 herë kampionin e botës që braktisi Mercedesin. Frederic Vasseur ka konfirmuar se do t'i japë mundësi pilotit britanik që t'i testojë disa makina të vjetra Ferrari para se ta provojë makinën zyrtare në testet dimërore. Duke folur për ardhmen e Hamiltonit te "kokëkuqja", menaxheri francez zbulon disa prapaskena interesante.



"Çuditërisht nuk ishte e vështirë për ta sjellë atë në Maranello. Në vitin 2004 punonim së bashku. Në fillim ai ishte në Mercedes dhe gjithmonë e kishte parasysh që herët a vonë mund të shkonte në Ferrari", u shpreh Vasseur. Më tej, menaxheri shtoi: "Gjëja më e rëndësishme është

performancë. Ai po vjen te Ferrari për këtë dhe kam ndjenjën se ne mund ta kemi makinën e duhur për një performancë të shkëlqyer. Ne po bëjmë shumë përpjekje në projektet tona dhe jam i sigurt se do të bëjmë një punë të shkëlqyer". Gjithsesi, Vasseur e ka ende mendjen te ky sezon dhe mundësia e fitimit të titullit kampion për konstruktorë: "Ne kemi shumë objektiva që mund t'i arrijmë. Në garat e fundit Charles dhe Carlos kanë qenë shumë në formë, ndaj duhet të vazhdojmë të shtyjme për ta përmirësuar makinën dhe do të shohim se ku mund të arrijmë".

SHKURT

Barazojnë Prishtina e Tereza, fitojnë pikët e para

Prishtina e Tereza i kanë fituar pikët e para në edicionin 2024/2025 në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të hendbollistëve. Të mërkurën mbrëma në Bardhosh, Prishtina e Tereza luajtën baras, 27:27. Ndeshja i takoi xhiros së shtatë të elitës së Kosovës të hendbollit. Në pjesën e parë, ekipi mysafir, Tereza, u shkëput deri në gjashtë gola. 11:5 ishte rezultati në minutën e 16. Prishtina ia doli të barazojë në 19:19 në minutën e 38. Sërish Tereza u shkëput, deri në katër gola. 26:22 ishte rezultati në minutën e 55-të. Diarta Shala (2), Fionë Krasniqi (2) e Nuriqe Qekaj shënuan pesë gola rresht për epërsinë 27:26 në të mirë të Prishtinës. Në minutën e fundit shënoi Ardiana Prapashtica e Terezës për rezultat përfundimtar, 27:27. Eduarta Kurteshi e Angelika Lubereka i shënuan nga gjashtë gola për Prishtinën. Nga pesë i kishin Diarta Shala e Ermira Berisha. Arjeta Imeraj i shënoi nëntë gola për Terezën, ndërsa gjashtë i kishte Ardiana Prapashtica. Tereza e Prishtina mbesin në dy pozitat e fundit në tabelë me nga një pikë.

Sane, synim i Unitedit dhe Arsenalit

Arsenali është i vendosur të konkurrojë me Manchester Unitedin për t'i siguruar shërbimet e sulmuesit të Bayern Munichut, Leroy Sane. Lajmin e konfirmoi sot e përditshmja gjermane "Bild". Sipas saj, dy gjigandët e Premier Ligës synojnë të rikthejnë sulmuesin, tashmë 28-vjeçar, që dikur është aktivizuar me Manchester Cityt. Futbollistit gjerman i skadon kontrata në fund të sezonit, ndaj do të jetë një lojtar i lirë. Leroy Sane ka shënuar tre gola në 11 ndeshje në të gjitha garat ku është aktivizuar këtë sezon për skuadrën e Vincent Kompany. Deri më tani nuk ka asnjë shenjë që tregon se ai dhe Bayerni po punojnë për rinovimin e kontratës.

De Ligt pas shkarkimit të Ten Hagenit: Nuk pati fat

Qendërmbrojtësi i Manchester Unitedit, Matthijs de Ligt, ka folur për largimin e trajnerit Erik Ten Hag. Holandezi nuk arriti të mbajë vendin si trajner në "Old Trafford", vend ku tashmë është ulur Ruben Amorim. "Normalisht, unë jam gjithmonë vetëkritik dhe mund të mërzitem për gjëra që nuk i bëj mirë. Por, këtu nuk mund të bëja asgjë për këtë, nuk mund të fajësoja veten për këtë", u shpreh De Ligt për të përditshmen "De Telegraaf". "Mendoj se Ten Hag nuk ka qenë shumë me fat, sidomos këtë sezon. Ne luajtëm mirë në shumë ndeshje, por nuk i shfrytëzuan rastet që krijuam. Është turp që duhet të përfundojë kështu, por ky është futbollit", ka shtuar mbrojtësi i Unitedit. De Ligt erdhi këtë verë te "djajtë e kuq", por nuk arriti të kontribuojë aq sa duhet. Këtë sezon ai ka luajtur në 15 ndeshje, duke realizuar edhe një gol.

Ranieri për herë të tretë trajner i Romës

Claudio Ranieri është zyrtarisht trajner i Romës. Lajmi u dha nga klubi përmes një postimi në rrjetet sociale. Rikujtojmë që kjo është hera e tij e tretë në bankinën e verdhekuqve pas asaj dyvjeçare 2009-2011, e cila përfundoi me dorëheqjen e tij

në mesin e sezonit të dytë dhe pas vitit 2019, kur mori drejtimin për ta mbyllur sezonin e Romës pas shkarkimit të Di Françeskos. Ranieri ka nënshkruar një kontratë deri më 30 qershor 2025. "Roma ka kënaqësinë të

njoftojë se Claudio Ranieri është trajneri i ri i ekipit të parë. Në përfundim të sezonit, Claudio do të kalojë në një rol të lartë ekzekutiv, ku do të jetë këshilltar i pronësisë për të gjitha çështjet sportive në klub. Kërkimi për një trajner të

ardhshëm do të vazhdojë gjatë muajve të ardhshëm. Claudio do të ketë kontribut edhe në atë vendim. I lindur në Romë dhe një romanist i përjetshëm, Ranieri veshi fanellën e verdhekuqve si lojtar gjatë sezonit 1973-'74 dhe më vonë

shërbeu si trajner i ekipit në dy raste të veçanta (nga 2009 në 2011 dhe në 2019). Ai është një simbol i vërtetë i vlerave të Klubit dhe një nga figurat më të respektuara të sportit romak në mbarë botën, thuhet në njoftimin e Romës.



U prilog članu 8, članu 10 pod st. 2.2 i člana 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 01.12.2010, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, i član 8. st. 4, član 11, član 21 pod st. 2.2 i član 25 Uredbe br. 55/21 o radnim odnosima N.P.L "Përparimi" Sh. A. u Vuçitru odobreno 21.12.2021 od strane Borda direktora N.P.L "Përparimi" Sh. A., a na osnovu rješenja br. protokola 1981/24 od 14.11.2024. godine glavnog izvršnog direktora, N.P.L "Përparimi" Sh. A od 14.11.2024 saopštava:

JAVNI KONKURS

- I. Naslov:** Čistač kancelarija i objekata
Broj izvršilaca: 1
Radno vrijeme: 40 sati sedmično
Trajanje termina: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.
Stručna priprema: Osnovna škola
radno iskustvo: Nije potrebno radno iskustvo
Izvršava: Rukovodioci Jedinice za održavanje - Čišćenje kancelarija i objekata
Koeficijent plate: 390.00 Euro Bruto

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Čistiće kancelarije i objekte u zavisnosti od ugovora koje poslodavac ima sa trećim licima;
- Čuvaće radni alat koji se koristi za čišćenje;
- Očistiće sve prostore za koje je upućen od nadređenog;
- Pridržavaće se pravila higijene i bezbednosti prema uputstvima pretpostavljenog kao i drugih obaveza u vezi sa radnim mestom a na osnovu zahteva pretpostavljenog;
- Obavlja druge poslove na osnovu naloga rukovodstva preduzeća;
- Za poslove koje obavlja odgovoran je rukovodiocu Jedinice za održavanje – čišćenje kancelarija i objekata;

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Prijavni obrazac za N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vuçitru. (skenirano);
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Ekstrakt rođenja; (certifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrda o krivičnoj osudi koju je izdao Sudski savet Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (uverenje izdato online na platformi e-Kosova će biti prihvaćeno);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

➤ Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

➤ Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

➤ Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od 15.11.2024 do 29.11.2024 u 16:00 sati.

Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:

- Prethodna verifikacija prijave kandidata najkasnije do 09.12.2024.
- Rok za žalbu je od 10.12.2024 do 13.12.2024.
- Period kada će kandidati polagati pismeni test, i kada će biti obavljena njihova evaluacija, biće najkasnije do 26.12.2024.
- Rok za žalbu je od 27.12.2024 do 30.12.2024.
- Period kada će kandidati obaviti usmeni intervju i kada će biti obavljena njihova evaluacija biće najkasnije do 06.01.2025.

- Rok za žalbu je od 08.01.2025 do 10.01.2025.
- Objavljivanje konačnih rezultata za uspješnog kandidata najkasnije do 17.01.2025.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se žalba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, pritužba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

➤ Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavni formular u Arhivu NPL "Përparimi" Sh. A u gradu Vuçitru, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vuçitru) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: hrperparimi@gmail.com.

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijaje se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

➤ ZAKLJUČAK

NPL "Përparimi" Sh. A u Vuçitru nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiču da se prijave.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Pajtim Deqaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I - IX shfmu "Mit' hat Frashëri" Krajk.
- Anita Stuja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit, dëftesat e kl. 10.11.12 dhe certifikatën e maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Rrezarta Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Faton Kastrati Vermicë, K.K Malishevë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. dhe diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Time Balaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I - VIII shfmu " Pjeter Budi" Lubizhd e Hasit.
- Shqipe Goranci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Petrit Xhoxhaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I - VIII sh.f.m.u "Leke Dukagjini" Prizren.
- Haxhi Ukshini nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Fanol Memqaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI - IX sh.f.m.u "Pjeter Budi" Lubizhd e Hasit.
- Kushtrim Halili, shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.l.e. "Hasan Prishtina".
- Teuta Muhadri nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Blerina Kastrati nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Qendrsa Shehu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Fakete Nallbani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA



Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A.

FERIZAJ

Në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Statutit të Ndërmarrjes, neni 37, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Stacionit të Autobusëve, me vendim të Kuvendit Komunal të Komunës të Ferizajt të datës 27.09.2024 për dhënien e pëlqimit, Stacioni i Autobusëve Sh.A në Ferizaj lejohet për dhënien në shfrytëzim të lokaleve afariste. Ky vendim është miratuar nga Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 12.11.2024.

NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A – Ferizaj shpallë:

ANKAND PUBLIK

Nr	Vendi i dhënies në shfrytëzim të pronës	Adresa e Pronës	Sipërfaqja	Cmimi fillestar {për_m ² }
1	Lokali, Stacionit të Autobusëve	Ferizaj	27.35 m ²	20.00 €
2	Lokali, Stacionit të Autobusëve	Ferizaj	29.60 m ²	20.00 €
3	Lokali, Stacionit të Autobusëve	Ferizaj	34.22 m ²	20.00 €
4	Lokali, Stacionit të Autobusëve	Ferizaj	10.75 m ²	20.00 €
5	Lokali, Stacionit të Autobusëve	Ferizaj	18.20 m ²	20.00 €
6	Lokali, Stacionit të Autobusëve	Ferizaj	33.00 m ²	20.00 €
7	Lokali, Stacionit të Autobusëve	Ferizaj	30.94 m ²	20.00 €
8	Lokali, Stacionit të Autobusëve	Ferizaj	28.73 m ²	20.00 €
9	Lokali, Stacionit të Autobusëve	Ferizaj	33.42 m ²	20.00 €
10	Lokali, Stacionit të Autobusëve	Ferizaj	210.02 m ²	20.00 €

Shënimi: Të gjitha çmimet janë pa TVSH.

Kriteri i dhënies së kontratës është: Çmimi më i lartë i ofruar.

1. Jepet në shfrytëzim afatshkurtër prej pesë (5) vjeç në hapsirat e Stacionit të Autobusëve.

2. Kontrata hyn në fuqi në momentin e fillimit të punës në Stacionin e ri.

Lokalet mund të vizitohen çdo ditë prej orës 08:00 deri në ora 16:00, deri më datën 27.11.2024, përveç të shtunëve, të dielave dhe ditëve të festave.

Lokali me numër tre (3) preferohet Market dhe Kafiteri, lokali me numër gjashtë (6) Burektore dhe Ëmbëltore, lokali me numër nëntë (9) Market, Fast Food ndërsa lokali me numër dhjetë (10) është i destinuar për Bifé, Restaurant.

Lokalet e tjera janë të destinuara për agjensione turistike, zyra postare, autoshkolla, freeshop, zyra për kryerjen e pagesa dhe veprimtari të tjera të ngjajshme.

KRITERET PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE

- Vlera e çmimit të ofruar nga ofertuesi

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSIT E PJESMARRËSVE NË ANKAND PUBLIK

- Të drejtë pjesëmarrje dhe konkurrimi, kanë të gjithë personat fizik dhe juridik të Republikës së Kosovës dhe investitorët e huaj.
- Një ofertues ka të drejtë të aplikojë në më shumë se një lokal.

DOKUMENTET E NEVOJSHME

- Nga e drejta e pjesëmarrjes në ankand janë të përjashtuar të gjithë debitorët që kanë obligime të pa shlyera ndaj Ndërmarrjes NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Ferizaj
- Fletë aplikacioni i plotësuar dhe i nënshkruar
- Letermjofitimi kopje
- Certifikata e cila dëshmon që nuk jeni nën hetime
- Certifikata e regjistrimit të biznesit (për subjektet juridike)
- Dëshmi mbi përbushjen e obligimeve tatimore ndaj ATK-së, (për bizneset vendore)
- Garancioni bankar në shumë prej 3,000.00 €.
- Pala e cila përfiton në Ankandin Publik para se të nënshkruaj kontratën duhet të bëjë pagesën e qeras paraprakisht për një (1) muaj.

ANKANDI PUBLIK DO TË JETË I HAPUR PËR 15 DITË KALENDRIKE:

- Nga data 13.11.2024 deri më 27.11.2024
- Ankandi publik do të jetë i publikuar në faqen e Stacionit të Autobusëve, tabelën e shpalljeve të Stacionit të Autobusëve.
- Hapja publike e ofertave bëhet më datë 02.12.2024 në Sallën e Kuvendit Komunal në ora 10:00.
- Tërheqja e aplikacioneve – kopja fizike mund të bëhet në zyrat e Stacionit të Autobusëve, çdo ditë nga ora 8:00 deri në ora 16:00.
- Oferta duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur dhe me ngjyrë të bardhë dhe pa asnjë shenjë identifikuese, në të cilën shënohet vetëm numri i lokalit për të cilin aplikohet.
- Dokumentacionet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.
- Tërheqja e aplikantëve nga ankandi publik mund të bëhet jo më vonë se tre (3 ditë) para hapjes së ofertës.
- Në rast se përfutuesi i parë tërhiqet ankandi do të anulohet dhe rishpallet rishitaz si dhe do të ekzekutohet garancioni bankar në favor të NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Ferizaj.

Kryesusi i Komisionit Vlerësues i Ofertave



Elvis Gashi
Elvis Gashi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



NDERMARRJA PUBLIKE LOCALE
PËR PËRPARIMI SH.A.1 - VUSHTRI
Protokollet: 1984/24
Data: 14.11.24

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A., e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 1981/24 të datës 14.11.2024 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A, me datë 14.11.2024 shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Pastrues i Zyrave dhe Objekteve

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla fillore

Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve

Koeficienti i pagës: 390.00 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga eprori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit dhe përgjegjësitë të tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së eprorit;
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

➤ Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërin nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

➤ Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

➤ Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të tij. Shpallja është e hapur nga data 15.11.2024 deri me datë 29.11.2024 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 09.12.2024.
- Afati për ankesë nga data 10.12.2024 deri me datë 13.12.2024.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 26.12.2024.

- Afati për ankesë nga data 27.12.2024 deri me datë 30.12.2024.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 06.01.2025.
- Afati për ankesë nga data 08.01.2025 deri me datë 10.01.2025.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 17.01.2025.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

➤ Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

➤ Përfundim

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Eko-Vasic" SH.P.K. me seli në Gjilan, si dhe me pronar Zvonimir Vasic, Draza Vasic, Stevan Vasic ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811181809 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Eko-Vasic" D.O.O. Gnjilane, sa vlasnikom Zvonimir Vasic, Draza Vasic, Stevan Vasic donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811181809 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Eko-Vasic" L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Zvonimir Vasic, Draza Vasic, Stevan Vasic has come to the decision to quit its business: 811181809 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

